

**20221502013**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SHËNDETËSORE**

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21,122/21 dhe 178/21), në nenin 141, pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, punonjësit shëndetësorë me arsim të lartë nga fusha e mjekësisë, të cilët në ditën e ngritjes së procedurës për regjistrimin e specializimit nga institucioni i arsimit të lartë që e zbaton specializimin, janë të punësuar në institucionin shëndetësor ose në ndonjë person tjetër juridik, që kryen veprimtari shëndetësor, mund të specializojnë, nëse krahas kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë edhe së paku gjashtë muaj stazh pune në profesion si punonjës shëndetësor me arsim të lartë ose kanë përvojë pune në institucion shëndetësor më gjatë se gjashtë muaj si punonjës shëndetësor me arsim të lartë”.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 2

Procedurat e filluara për miratim për dërgim në specializim të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë nga sfera e mjekësisë në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21,122/21 dhe 178/21), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.